



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 72 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ashtu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2050 (dymijë e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 28.04.2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet, se në rrugën “Rifat Berisha” në Ferizaj, mbi posterin e kandidatit për kryetar Komune së Ferizajt Adem Salihaj nga radhët e subjektit politik LDK, sipas parashtruesit të ankesës është mbuluar në pjesën e poshtme me posterin kandidatit për kryetar komune të Ferizajt Agim Aliu, nga radhët e subjektit politik PDK.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi një fotografi.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK, më datë 28.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.04.2012, në ora 12:00.

PZAP-i, me datën 28.04.2012, mori përgjigjen e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se PDK, gjatë gjithë kohës ka lajmëruar simpatizantët dhe militantët e PDK-së, se nuk guxojn të bëjnë shkelje të Kodit Zgjedhor. Sipas përgjigjes në ankesë PDK potencon se pretendimet e subjektit politik LDK, kinse subjekti politik PDK ka mbuluar posterin e kandidatit të LDK-së, mendojmë se këto fakte janë nga ana e militantëve të LDK-së, me qëllim të dëmtimit të subjektit politik PDK.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografia që gjenden në shkresat e lëndës e dorëzuar si provë, PZAP-i ka konstatuar se posterit i kandidatit për kryetar Komune të Ferizajt Agim Aliu, nga radhët e subjektit politik PDK, është i vendosur mbi posterin e kandidatit për kryetar Komune të Ferizajt Adem Salihaj, të subjektit politik LDK. PZAP-i mori parasysh të gjitha rrethanat si lehtësuese ashtu edhe rënduese për rastin konkret PZAP-i, vlerësoi se nuk pati rrethana lehtësuese ndërsa si rrethana rënduese, mori parasysh faktin se subjekti i njëjtë politik ka përsërit shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre. Prandaj nga arsyet e lartcekura dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve të sipërshënuara, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 72/2012 më datën 30.04.2012

